



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:017590
Datë: 09.10.2018
Numri i dokumentit: 00149421

P. nr.497/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **DIANA SINA**, me sekretaren juridike Lamije Kuqi, në çështjen penale kundër të akuzuarit N.B. nga Gj., për shkak të veprës penale, vjedhje e shërbimeve komunale, nga neni 320 të KPRK-ës, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore-Dep.përgjithshëm në Gj., PP.nr.210/2017 të datës 21.07.2017, në shqyrtimin publik gjyqësor, të mbajtur më datën **09.10.2018**, në prani të Prokurores së shtetit Dëshire Jusaj, të akuzuarit, të dëmtuarit Përfaqësuesit të autorizuar i K.-Gjakovë, të njëjtën ditë mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **N. B.**, i biri i D., i nënës G., e gjinisë B., data e lindjes ... në Gj., ku edhe tani banon, në rrugën “H.D.” nr.2.... ka të kryer shkollën e mesme, punëtor, i martuar- atë i 3 fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Bazuar në nenin 363 par.1 nën par.1.1 të KPPK-ës:

REFUZOHET AKUZA

Sepse; Nga data e pavërtetuar e deri me dt.25.05.2016 në shtëpinë e tij në Rr.”H. D.” nr.2... në Gj., me qëllim që vetit ti sjell përfitim pasuror të kundërligjëm me qëllim fitimi në mënyrë të paautorizuar ka shfrytëzuar energjinë elektrike në atë mënyrë që njehsorit elektrik me nr.600..... ia ka kthyer kapakun nga ana e epërme, përmes pjesës së thyer ka depërtuar në brendi ku përmes një cope druri ka bllokuar rrotullimin e diskut, ku me këtë veprim ka penguar regjistrimin e sakët të energjisë elektrike të shpenzuar, gjendje kjo e konstatuar nga personat e autorizuar në cilësi të ekspertit të kalibrimit të Divizionit të rrjetit në Prishtinë me rastin e kontrollës, me ç’ rast të dëmtuarën K.-Divizioni i Rr. –d. në Gj. i ka shkaktuar dëm në shumë prej 205.71 euro.

-me çka do të kishte kryer veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale, nga neni 320 te KPRK-ës.

E dëmtuara K.-D. i rrjetit D. në Gj., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

-Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, ka ngritë Aktakuzë PP.nr.210/2017 të datës 21.07.2017, kundër të akuzuarit N. B. nga Gj., për shkak të veprës penale, vjedhje e shërbimeve komunale, nga neni 320 të KPRK-ës, dhe ka propozuar që i akuzuari të shpallet fajtor, të dënohet sipas Ligjit dhe të obligohet në kompensimin e shpenzimeve gjyqësore.

Prokurori i shtetit pasi lexoi aktakuzën bënë përmisimin e dispozitivit të aktakuzës në rreshtin e dytë ashtu që në vend K.M. duhet të jetë K.Gj. ndërsa pjesa tjetër e dispozitivit të aktakuzës mbetet e pa ndryshuar.

Në shqyrtimin fillestar të dt.26.06.2018 i akuzuari N. B. nuk e pranon fajësinë për veprën penale me të cilën akuzohet, me arsyetim se unë në periudhën kohore prej datës së pa vërtetuar e gjer me dt.25.05.2016 në kohën e përcaktuar në aktakuzë unë nuk kam qenë shfrytëzues i këtij njehsori elektrik, ky njehsor elektrik ka qenë i vendosur në shtëpinë e N. K. të cilën unë e kam marr me qira me dt.01.06.2016, do të thotë pas kohës së kryerjes së veprës penale, unë kam filluar që të shfrytëzoj energjinë elektrike me njehsorin e ri elektrik nga dt.01.06.2016.

Në shqyrtimin gjyqësor në procedurën e provave janë dëgjuar dëshmitarët, A.R., Sh. H., dëshmitarja S. S.H. dhe dëshmitarja N. B.

Në shqyrtimin gjyqësor të dt.09.10.2018, e dëmtuara Përfaqësuesi i autorizuar i K.-L. M. deklaroi se pasi i dëgjova dëshmitë e dëshmitarëve A.R., Sh. H. punëtor të autorizuar të K.-në Gj., pas dëgjimit të dëshmitares S. S. H. si anëtare e komisionit të qendrës së kalibrimit në P., e sidomos pas dëgjimit të dëshmitares N.K.B., e cila sqaroi shumë kuart se shtëpinë e cila gjendet në rrugën H.D. ku është keqpërdorur njehsori elektrik me nr.60.... ia ka lëshuar me qira këtu të akuzuarit N. B. me dt.01.06.2016, do të thotë është vërtetuar se këtu i akuzuari N.B. nuk e ka keqpërdorur këtë njehsor elektrik pasi që koha e kryerjes së veprës penale është nga data e pa vërtetuar e gjer me dt.25.05.2016, do të thotë para datës që i akuzuari N. B. që ka qenë duke e shfrytëzuar shtëpinë e N.B., gjithashtu me dt.04.10.2018 në arkat e K.-D. në Gj., është bërë pagesa e rikthimit të humbjeve në vlerë prej 205.71 euro, e ku vërehet që nënshkrimi i përket N.K., gjithashtu i prezantoi gjykatës fotokopjen e pagesës së bërë, atëherë unë si përfaqësues i palës së dëmtuar K.-Di.në Gj., tërhiqem nga kallëzimi penal ndaj të akuzuarit N.B. dhe do të shqyrtoj mundësinë për një kallëzim penal të rij ndaj N.K.B..

Prokurorja e shtetit Dëshire Jusaj pasi dëgjoi përfaqësuesin e autorizuar i të dëmtuarës K.-D. në Gj., L.M. deklaroi, pasi që përfaqësuesi i të dëmtuarës K. heq dorë nga kallëzimi penal me pretendimet siç e theksoi më lartë si dhe me synimin e një kallëzimi penal për të dyshuarën N. B. për veprën penale të vjedhjes së shërbimeve komunale, nga neni 320 të KPRK-së, edhe unë si prokurore e rastit tërhiqem nga ndjekja penale këtu ndaj të akuzuarit N.B., për shkak të veprës penale të vjedhjes së shërbimeve komunale, nga neni 320 të KPRK-së.

Pasi që Prokurori i shtetit është tërhequr nga ndjekja penale ndaj të akuzuarit N. B., për shkak të veprës penale të vjedhjes së shërbimeve komunale, nga neni 320 të KPRK-së. Gjykata në bazë të nenit 363 par.1 nën par.1.1 të KPPK-ës, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 par.3 të KPPK-ës.

Vendimi që shpenzimet e procedurës penale të bien në barrën e mjeteve buxhetore, gjykata e morri në mbështetje të nenit 454 par.1 të KPPK-ës.

Nga sa u tha më lart u vendosë si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
-Departamenti i përgjithshëm-
P. nr.497/17 më datë 09.10.2018.**

**Sekretarja juridike,
Lamije Kuqi**

**Gjyqtarja e vetme gjykuese
Diana Sina**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afatin prej **15 ditësh**, nga dita e marrjes së tij në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2018:017590
Datë: 09.10.2018
Numri i dokumentit: 00149421